



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 930/2 prot

Datë 03.05.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-63641-03-27-2023, me objekt: “*Shpenzime për blerje Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi*”, me fond limit 1.979.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër SH.A
- Ankimues:** Operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 10, Vorë, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër SH.A
Adresa: Rr. Muharrem Gega, Gjirokastër.
- Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.
Adresa: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Tiranë.

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK ka paraqitur ankesë me numër ankimi elektronik A/2023/3065 datë 29.04.2023, protokolluar me Nr. 930/2023, datë 02.05.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-63641-03-27-2023, me objekt: “*Shpenzime për blerje Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi*”, me fond limit 1.979.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertë së paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK, në ankesën me nr. 930 prot., datë 02.05.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, fitues në këtë procedurë prokurimi. Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje të kriterëve si më poshtë vijon:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.2.2- *Ofertuesi duhet të paraqesë një vërtetim që ka paguar detyrimet e ujit të pijshëm dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.)

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr. 9.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2. *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, si dhe të gjitha shpenzimet e parashikuara në shtojcën e specifikimeve teknike.*
6. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik certifikatën e analizës nga Instituti i Shendetit Publik, për analizë toksikologjike për produktet që prokurohen (operatori ekonomik është i detyruar ta paraqesë dokumentacionin e mesiperm për ato elementë toksikologjikë që realizon ISHP) ose (certifikatën e analizës toksikologjike të produkteve lëshuar nga laboratorë të akreditur sipas legjislacionit në fuqi të Republikës të Shqipërisë) jo me vone se 3 muaj.*
7. *Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera 1 mjet të autorizuar për transport kimikatesh për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE.*
8. *Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

a)Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi) për “Transport lende të rrezikshme” ,lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij , certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme), duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës

objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

b)Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

Shënim: *Për pikat 7 dhe 8 operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 03.05.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri